



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 853/1 Prot

Tiranë, më 22/08 / 2016

Lënda: *Jepet mendim mbi Draft - Marrëveshjen "Për përhapjen e të dhënave personale të kandidatëve për student në IAL për vitin akademik 2016 – 2017 nga Agjencia Kombëtare e Provimeve tek Qendra Ndëruniversitare e Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik"...*

Drejtuar: AGJENCISË KOMBËTARE TË PROVIMEVE
Znj. Rezana VRAPI
DREJTORE E PËRGJITHSHME

TIRANË

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.1406/1 Prot, datë 09.08.2016, Draft - Marrëveshja "Për përhapjen e të dhënave personale të kandidatëve për student në IAL për vitin akademik 2016 – 2017 nga Agjencia Kombëtare e Provimeve tek Qendra Ndëruniversitare e Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik", vlerësohet e hartuar konform kërkesave të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Nëse përhapja e të dhënave personale të studentëve nuk konsiston vetëm jashtë vendit por edhe brenda tij, të vlerësohet në përmbajtje të draft marrëveshjes përdorimi i termave të përcaktuar kryesisht në nenin 3, pikat 16 dhe 19 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Ndërsa, sa i përket "transferimit të të dhënave të studentëve" që do të realizoni sipas kësaj Marrëveshje, ju orientojmë që pas konsultimit me nenin 8 dhe 9 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar si dhe Vendimit të Komisionerit nr.3/2012 "Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale" i ndryshuar, të vlerësoni depozitimin e kërkesës për pajisjen me Autorizimin përkatës pranë Zyrës së Komisionerit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

